Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);
- b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1;
- c. Sigurimin e ofertës, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 4;
- ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
- d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 8/1;
- e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Objekti i veprimtarisë së Operatoreve Pjesemares duhet të perputhet me objektin e prokurimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a. Kopje të certifikuara të bilanceve të paraqitura në autoritetet përkatëse (Administrata Tatimore) të tre viteve të fundit, konkretisht të viteve 2017, 2018, 2019.
- b. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore për tre vitet e fundit, ku xhiroja mesatare e tre viteve, konkretisht 2017, 2018, 2019 të mos jete më e ulët se 72,000,000 (Shtatëdhjetë e dy milion) leke pa tvsh.
- c. Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e paguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, ku vlera duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 72,000,000 (Shtatëdhjetë e dy million) leke pa tvsh.

Ne rast se kontrata është kryer me ente publike:

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Ne rast se kontrata është kryer me sektorin privat:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori i shërbimit duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme:

- a) **ISO 9001** për sistemin e menaxhimit të cilësisë (të vlefshme), ose ekuivalente, të përditësuar, e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e produkteve apo shërbimeve që prokurohen;
- b) Certifikatën për menaxhimin e shërbimeve **ISO 20000-1:2011** ose ekuivalente të përditësuar, e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e produkteve apo shërbimeve që prokurohen,
- c) Certifikatën për menaxhimin e informacionit **ISO 27001:2013** ose ekuivalente të përditësuar, e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e produkteve apo shërbimeve që prokurohen.

Çertifikatat të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të VKM-914 datë 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas aktmarrëveshjes.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të zoterojë kompetencën apo specializimin teknik “Advanced Data Center Architecture Specialization” për teknologjinë Cisco ose ekuivalente me të.

Te paraqitet certifikata e kompetences ose adresa web në të cilën mund të verifikohet.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të zoterojë kompetencën apo specializimin teknik “Advanced Enterprise Networks Architecture Specialization” për teknologjinë Cisco ose ekuivalente me të.

Te paraqitet certifikata e kompetences ose adresa web në të cilën mund të verifikohet.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të zoterojë kompetencën apo specializimin teknik “Advanced Security Architecture Specialization” për teknologjinë Cisco ose ekuivalente me të.

Te paraqitet certifikata e kompetences ose adresa web në të cilën mund të verifikohet.

2.3.6. Operatori Ekonomik duhet të zoterojë kompetencën apo specializimin teknik “Server Virtualization” për teknologjinë VMware ose ekuivalente me të, referuar zerave respektive të objektit të prokurimit.

Te paraqitet certifikata e kompetences ose adresa web në të cilën mund të verifikohet

2.3.7. Operatori Ekonomik duhet të zoterojë kompetencë ose specializim teknik për shërbimet e DellEMC referuar zgjidhjeve ekzistuese DellEMC.

Te paraqitet certifikata e kompetences ose adresa web në të cilën mund të verifikohet.

2.3.8. Ofertuesi të paraqesë Autorizim nga Prodhuësi/distributori, për Garancinë për Suport perkatesisht nga HP, DellEMC, Fujitsu, Cisco, Imperva, VMware, Symantec, Veeam, CheckPoint referuar teknologjive ekzistuese të OSHEE dhe objekt i këtij prokurimi. Autorizimi i Prodhuësit/Distributorit duhet të përfshijë detaje për kontaktin. Në rast të paraqitjes së autorizimit të Distributorit të verifikohet lidhja mes Prodhuësit dhe Distributorit.

2.3.9. Operatori ekonomik duhet të deshmojë që ka stafin e nevojshëm teknik të kualifikuar për suportin e sistemeve të ofertuara dhe respektivisht në përbërje të stafit të Operatorit Ekonomik duhet të jenë:

- Te pakten 2 (dy) specialiste të certifikuar HP për të suportuar dhe mirembajtur serverat ekzistues HP.
- Te pakten 2 (dy) specialiste të certifikuar në nivel “Implementation Engineer” për të implementuar dhe suportuar upgrade të storage ekzistues DellEMC Unity 400 Family dhe EMC VNX52000/5400.
- Te pakten 2 (dy) specialiste të certifikuar në nivel profesional “VCP” për të suportuar dhe mirembajtur zgjidhjen ekzistuese VMware.
- Te pakten 2 (dy) specialist të certifikuar në nivel ekspert (CCSE) për të suportuar zgjidhjen ekzistuese Checkpoint.
- Te pakten 1 (një) specialist të certifikuar në nivel Profesional “CCNP” për të suportuar zgjidhjen ekzistuese Cisco Networking për “Routing and Switching”.

- Te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar ne nivel Profesional “CCNP” per te suportuar zgjidhjen ekzistuese te sigurise Cisco per “Security”.
- Te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar ne nivel “Implementation Engineer” per te suportuar dhe mirembajtur serverat ekzistues Dell PowerEdge.
- Te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar "Implementation Engineer" per te implementuar dhe suportuar zgjidhjen ekzistuese “Deduplication Hardware Appliance EMC DD2200 dhe DD6300”.
- Te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar "Data Protection System Engineer" per te implementuar dhe suportuar zgjidhjen ekzistuese “Fujitsu Storage DX200”.
- Te pakten 1 (nje) specialiste te certifikuar Fujitsu "Server System Engineer" per te suportuar dhe mirembajtur serverat ekzistues Fujitsu.
- Te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar per sigurine e databazes per te suportuar dhe mirembajtur zgjidhjen ekzistuese Imperva Database Activity Monitoring.
- Te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar per sigurine Web per te suportuar dhe mirembajtur zgjidhjen ekzistuese Imperva Web Application Firewall.
- Te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar per te suportuar dhe mirembajtur zgjidhjen ekzistuese Microsoft Exchange.

Per te gjithë punonjesit e mesiperm, duhet te paraqiten certifikatat perkatese si dhe operatori ekonomik duhet te vertetoje se i ka te punesuar dhe t'i kete te pasqyruar ne formularet E-Sig 025.

Nje punonjes mund te kete 1 ose disa certifikime.

Per kete qellim operatori ekonomik duhet te paraqesi:

-certifikatat perkatese per secilin nga specialistet e mesiperm;

-lispagesat e dorezuara nepermjet formes elektronike ne organet kompetente, nga organet tatimore Tetor 2020, Nendor 2020.

Per cdo produkt dhe garanci per support te ofruar duhet te jepet Part-Number (ose te gjithë part nr. kur produkti eshte kompleks) i sakte i prodhuesit, ne menyre qe te lehtesohet verifikimi.

Operatori i huaj ekonomik duhet t'i plotesoje te gjitha kushtet e mesiperme duke paraqitur dokumentat perkatese leshuar nga institucionet pergjegjese ne shtetin e tyre konform ligjieve ne fuqi.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, parametrat teknik etj: Sipas materialit bashkelidhur ne PDF

Specifikimi i Materialeve: Sipas materialit bashkelidhur ne PDF

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Subjekti duhet të sigurojë Shperndarjen ne cdo pike te OSHEE brenda Tiranes dhe ne te gjitha rrethet e Shqiperise sipas listes se meposhtme

Specifikime Teknike

Sasia e mallit që kërkohet:

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Sasia
1	<i>Furnizim Vendorsje Upgrade për Hardware dhe Software</i>	
1.1	F. V. Upgrade Network Card të dy serverave ekzistues Dell PowerEdge R940	2/copë
1.2	F. V. Upgrade i kapacitetit të Storage ekzistues Dell EMC UNITY 400 (Primary Site)	1/set
1.3	F. V. Upgrade të Licencave CheckPoint VPN/Mobile Remote Access	1/set
1.4	F. V. Upgrade i licencave të Network Access Kontroll për 1500 user	1500/copë
1.5	F. V. Upgrade licensa Symantec Protection Suite Enterprise Edition	500/copë
1.6	F. V. Upgrade licensa Symantec Web Security and Web Applications	500/copë
1.7	Blerje Workstation	50/copë
1.8	Blerje PC standard	250/copë
1.9	Blerje Laptop standard	100/copë
1.10	Blerje për HelpDesk	1/set
1.11	F. V. Rinovim licensa TeamViewer	2/set
1.12	F. V. Rinovim licensa ThinkCell	1/set
1.13	F. V. Sistem për autentifikim të dyfishtë	1/set
1.14	F. V. Sistem i unifikuar për menaxhimin e Microsoft Active Directory	1/set
1.15	F. V. Sistem për audim në kohë reale të Microsoft Active Directory	1/set
2	<i>Garanci për suport për infrastrukturën e serverave</i>	
2.1	Garanci për Suport HP Servers	1/vit
2.2	Garanci për Suport DELL Server	1/vit
2.3	Garanci për Suport CISCO Servers	1/vit
2.4	Garanci për Suport Fujitsu Servers	1/vit
3	<i>Garanci për Suport për Data Storages.</i>	
3.1	Garanci për Suport për Data Storage EMC VNX5400 (Primary Site).	1/vit
3.2	Garanci për Suport për Data Storage EMC VNX5200 (DR Site)	1/vit
4	<i>Garanci për Suport për Dedup Appliances</i>	
4.1	Garanci për Suport për Dedup Appliance EMC DD2200 (Primary Site)	1/vit
4.2	Garanci për Suport për Dedup Appliance DD6300(Primary Site)	1/vit
4.3	Garanci për Suport për Dedup Appliance EMC DD2200 (DR Site)	1/vit
5	<i>Garanci për Suport për Infrastrukturën Network</i>	
5.1	Garanci për Suport për (Network Routers&Switches, SAN Swithces, ASA Firewall, ASA subscription, Cisco Firepower Management, Cisco Prime Infrastructure, ISE dhe Wireless Controller)	1/vit

6	<i>Garanci për Suport për Sistemet Software.</i>	
6.1	Garanci për Suport për Backup Software ekzistues EMC Networker Capacity-Based	1/vit
6.2	Garanci për Suport për Software ekzistues EMC RecoverPoint	1/vit
6.3	Garanci për Suport për Software ekzistuese VMware	1/vit
6.4	Garanci për Suport për Software ekzistues VEEAM	1/vit
6.5	Garanci për Suport CheckPoint Firewalls Software	1/vit
6.6	Garanci për Suport Imperva DB Audit&Web Application Firewall	1/vit
6.7	Garanci për suport i licensave ekzistuese Symantec Endpoint Protection & Mail Filtering	1/vit
6.8	Garanci për suport i licensave ekzistuese Symantec Web Security and Web Applications.	1/vit
6.9	Garanci për Suport dhe Mirëmbajtje Exchange Server 2016	1/vit
7	<i>Garanci për Suport për Server Room</i>	
7.1	Mirembajtje e Kondicionim Room Server primar dhe Sekondar	1/vit
7.2	Mirembajtje e UPS për room server Primar dhe Sekondar	1/vit
8	Instalim dhe konfigurim për upgrade/furnizim/vendosje të produkteve në këtë prokurim.	60/Ditë

1. Furnizim Vendosje Upgrade për Hardware dhe Software

1.1 Upgrade Network Card të dy serverave ekzistues Dell PowerEdge R940

OSHEE Group sh.a. kërkon të bëjë upgrade të kapacitetit të nderfaqeve network për dy serverat ekzistues Dell PowerEdge R940.

Service tag te serverave ekzistues: 8VTBFV2; 8VT9FV2.

- Netwok adapter me katër porta 10Gb sfp+, transcieverat të përfshirë.
- Ndërfaqe PCI-Express.
- Protokoll 10 GB ethernet.
- Të ofrojë performancë të lartë për aplikacionet e rrjetit.
- Transciever 10Gb sfp+ të ofrohen për fibër multimode, konektor duplex LC.
- Vendosja, instalimi i kartave Ethernet PCI-ene shasine e serverit dhe konfigurimi i tyre ne raid duhet te behet nga kompania ofertuese.
- Garancia për support duhet të ofrohet nga prodhuesi ose partneri i autorizuar për shërbime nga prodhuesi për një periudhe 1 vjeçare në nivelin 24 orë ne ditë në 7 ditë të javës.

1.2 Upgrade i kapacitetit të Storage ekzistues Dell EMC UNITY 400 (Primary Site)

OSHEE Group sh.a. kërkon të bëjë upgrade të kapacitetit të storage ekzistues Dell EMC Unity 400.

- Shtim shasi për disqe, kapacitet max 25 x disqe 2.5”.
- Shasi nga i njëjti prodhues i Primary Storage.
- Shasi me madhësi 2 rack unit.
- Shasi me burim të dyfishtë ushqimi.
- Shtim kapaciteti me 16 copë disqe 1.6 TB SSD.
- Disqe nga i njëjti prodhues i Primary Storage

1.3 Upgrade të Licencave CheckPoint VPN/Mobile Remote Access

OSHEE Group sh.a. ka të implementuar zgjidhjen CheckPoint Security Gateway me disponueshmëri të lartë në infrastrukturën e saj.

Në këtë prokurim, OSHEE Group sh.a. kërkon të bëjë upgrade me licensa për CheckPoint VPN/Mobile remote akses për numër të pakufizuar përdoruesish të njëkohshëm të Security Gateway për Secondary site.

- Garancia e ofruar nga prodhuesi duhet të jetë për një periudhë 1 vjeçare.

Part Number	Pershkrimi	Sasia
CPSB-MOB-U	Check Point Mobile Access Blade for unlimited concurrent connections	1
CPCES-CO-STANDARD-ADD	Standard Collaborative Enterprise Support For 1 Year	1

1.4 Upgrade i Network Access Kontroll.

OSHEE Group sh.a. ka të implementuar një sistem, i cili ofron politika bazë të sigurisë së përdoruesve në rrjet. Sistemi aktual është i implementuar në dy nyje të ndara, të cilat ofrojnë disponueshmëri të lartë.

- Numri i kontratës: **201280121**

Kërkesat e sistemit:

OSHEE Group sh.a. kërkon të zhvillojë më tej sistemin aktual, duke garantuar vizibilitet sa më të detajuar të tipareve të pajisjeve, të cilat aksesojnë rrjetin e kompanisë.

- Sistemi duhet të përmirësohet që të realizojë identifikimin e profilit të 1500 user-a të lidhur në rrjet përmes pajisjeve fizike, si:

- Telefona IP.
- Printera.
- Kamera IP.
- Smartphone.
- Tabletë.
- Etj.
- Sistemi duhet të krijojë template të personalizuar për pajisjet fundore, në mënyrë që të bëhet identifikimi i tyre automatikisht, sapo të lidhen në rrjetin e kompanisë.
- Sistemi duhet të krijojë rregulla/role specifike për të mundësuar autorizim në rrjet bazuar në tipin e pajisjes.
- Sistemi duhet të mbledhë të dhëna mbi tiparet e pajisjeve fundore, duke i monitoruar ato në momentin e autentikimit në rrjet.
- Sistemi të ketë mundësi të mbajë të përditsuar databazën me adresat IP më të reja, të cilat kanë marrë akses në rrjet.
- Licencat të jenë i të njëjtit prodhues me zgjidhjen ekzistuese.

Garancia e sistemit:

- Garanci për një periudhë 1 vjeçare nga prodhuesi dhe në qendrën e tyre të shërbimit.
- Garanci për periudhën 1 vjeçare për përmirsimin e software të sugjeruar nga prodhuesi.

1.5 Upgrade licensa Symantec Protection Suite Enterprise Edition

OSHEE Group sh.a. ka në përdorim 1000 licensa Protection Suite Enterprise Edition. Në këtë fazë OSHEE Group sh.a kërkon të bëjë upgrade me 500 licensa te tjera. Produkti i ofruar duhet të jetë në përputhshmëri të plotë me produktin ekzistues. Data e mbarimit të suportit të licensave të reja duhet të jetë e njëjtë me atë të licensave ekzistuese.

Garancia duhet të ofrohet nga prodhuesi për një periudhe 1 vjeçare

1.6 Upgrade licensa Symantec Web Security and Web Applications.

OSHEE Group sh.a. ka në përdorim 1000 licensa Web Security and Web Applications. Në këtë fazë OSHEE Group sh.a kërkon të bëjë upgrade me 500 licensa te tjera. Produkti i ofruar duhet të jetë në përputhshmëri të plotë me produktin ekzistues. Data e mbarimit të suportit të licensave të reja duhet të jetë e njëjtë me atë të licensave ekzistuese.

Garancia duhet të ofrohet nga prodhuesi për një periudhe 1 vjeçare.

1.7 Blerje PC Workstation advanced (50 copë).

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE

Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	12000 Pikë
“RAM”:	32 GB, min. DDR4 2666 MHz, ECC
Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:	(1) x 256 GB SSD Sistemi Operativ dhe (2) x 1000 GB HDD
Shpejtësia e Hard Diskut “HDD Speed”: “Disk Subsystem Controller”:	7200 RPM SATA 6.0 Gb/s për HDD Serial ATA III 6.0 Gb/s, Minimum 4 Serial ATA Interface with RAID 0,1,5,10 Support. (Hard Disk të Konfiguruar në RAID 1).
Karta Grafike “Graphics”:	Kartë Grafike HD e Dedikuar PCI-E x16, Minimum 4 GB Memory; Min. (2) Porta (VGA/DVI/HDMI/DP, mund të përdoret dhe adaptor). Karta të jetë e rekomanduar dhe instaluar nga prodhuesi për workstation.
“Media Device”:	DVD+/-RW with Dual Layer DVD+R wri. Capacity
“Slots”:	Minimum (4) PCI/PCI-E nga të cilat min. (2) PCI-E x16
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (10) USB nga të cilat: a. Min. (4) USB Para; b. Min. (6) USB 3.0 (2) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë Video (mund të përdoret dhe adaptor)
Rrjeti “Networking”:	(2) 10/100/1000 LAN Gigabit Ethernet Port
“Sound”:	Integrated Sound Card
“Speakers”:	Internal speakers or Built-in Monitor
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM 2.0
Tastiera “Keyboard”:	Standart Keyboard QWERTY
“Mouse”:	Minimum 3 Button scroll Optical
Ushqimi “Power Supply”:	220 V AC , 50 Hz
Kursimi i energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
AKSESORËT Kabëll “Power Cord”:	Po, European
“Recover”:	Recover Partition
MONITORI Tipi “Type”:	LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin
Madhësia “Size”:	≥ 23"
Rezolucioni “Native Resolution”:	1920 x 1080 @ 60 Hz
Raporti i Kontrastit “Contrast Ratio Static”:	1000:1
Koha e Rifreskimit “Response Time”:	≤ 6 ms

“Display Port”:	(1) VGA ose DVI dhe (1) prej Portave DP/DVI/HDMI
Kursimi i energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
Ushqimi “Power Supply”:	220 V AC , 50 Hz
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë	3 Vjet
“Warranty”:	

1.8 Blerje PC standard (250 copë)

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE

Pikët Min. për Procesorin sipas:	7900 Pikë
cpubenchmark.net	
Min Proc. Rating According to:	
cpubenchmark.net:	
“RAM”:	8 GB DDR4, min. 2666 MHz, Non-ECC
Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:	500 GB
Shpejtësia e Hard Diskut “HDD Speed”:	7200 RPM SATA 6.0 Gb/s
“Disk Subsystem Controler”:	Serial ATA III 6 Gb/s
Karta Grafike “Graphics”:	Integrated graphic Card, min. 1 GB
“Media Device”:	DVD+/-RW
“Slots”:	Min. (3) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16

KOMUNIKIMI & MENAXHIMI

Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (8) USB nga të cilat: a. Min. (3) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0
--------------------------------------	---

Rrjeti “Networking”:	(1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë DP/DVI/HDMI/VGA (1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port
“Sound”:	Integrated Sound Card
“Speakers”:	Internal or Built-in Monitor
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM 2.0
Tastiera “Keyboard”:	Standart Keyboard QWERTY
“Mouse”:	Minimum 3 Button Scroll Optical
Ushqimi “Power Supply”	220 V AC, 50 Hz
Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
“Recover”:	Recover Partition
MONITORI	
Tipi “Type”:	LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin
Madhësia “Size”:	≥ 21”
Rezolucioni “Native Resolution”:	1920 x 1080 at 60 Hz

Raporti i Kontratit “Constrast Ratio Static”:	1000:1
“Display Port”:	(1) VGA dhe të paktën (1) prej portave DP/DVI/HDMI
Koha e Rifreskimit “Response Time”:	≤ 6 ms
Kursimi i Energjisë “Energy Efficency”:	Energy Star
Ushqimi “Power Supply”:	220 V AC, 50 Hz
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë	3 Vjet
“Warranty”:	

1.9 Blerje Laptop standard (100 copë).

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE

Pikët Min. për Procesorin sipas:	4500 Pikë
cpubenchmark.net Min Proc. Rating	
According to: cpubenchmark.net:	
“Chipset”:	Intel ose Ekuivalent
“RAM”:	8 GB, DDR4 min. 2133 MHz, Non-ECC
Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:	500 GB HDD, 7200 RPM SATA
“Graphics”:	Integrated Graphics with 1 GB Video Memory
“Media Device”:	DVD+/-RW with DL Internal ose External; Memory card reader
Ekrani “Display”:	15.6” LED HD (1366 x 768), Anti Glare
Bateria “Battery”:	Min. 45 Wh
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit “Ports”:	Min. (3) porta USB nga të cilat min. (2) USB 3.0 (1) DisplayPort/HDMI (1) Integrated Mic. (1) Integrated HD Web Camera (1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack
Rrjeti “Networking”:	10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45); Wireless 802.11ac (Kompatibël me 802.11 b/g/n); Bluetooth min. V4.0
“Sound”:	Integrated , (2) x built-in speakers (stereo)
Tastiera “Keyboard”:	QWERTY
“Pointing Device”:	Touch Pad
Siguria “Security Management”:	Embedded Security TPM 2.0
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
Ushqyesi “Recharger”:	Po

“Mouse”:	Po, i të njëjtës Markë me Laptopin
Çanta “Carrying Bag”:	Po, nga Prodhuesi. E përshtatshme për Laptop dhe Aksesorët e tjerë.
“Recover”:	Recover Partition
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë	3 Vjet
“Warranty”:	

1.10 Blerje për HelpDesk.

Nga OSHEE Group sha. kërkohet lista e pajisjeve dhe software te mëposhtëm për nevojat e Helpdesk:

	sasia (copë)
RAM DDR3 (2GB, min. 1600 Mhz)	100
RAM DDR4 (8GB, min. 1600 Mhz)	100
Tastierë me USB	20
Mouse me USB 3 butona, (1,5m gjatësia e kabllit)	100
Kabëll HDMI 10m	5
Kabëll VGA 2 m	50
Kabëll DVI 2 m	50
USB 3.0 to RJ45 cable (male to female) adapter	5
USB extension 2m	10
Kabëll rrjeti CAT 5e	600 m
Patch Cable CAT 5e (0.5M)	200
Patch Cable CAT 5e (1M)	200
Patch Cable CAT 5e (3M)	100
Patch Cable CAT 5e (5M)	100
Patch Cable CAT 5e (10M)	20
Console Cable	3
Usb To serial Converter	3

USB 3.0 flash drive 16 GB	50
USB 3.0 flash drive 32 GB	50
SSD i jashtëm USB 3.0, 1 TB	10
HDD Sata 1TB 7200 RPM, SATA III	20
SSD 480 GB, SATA III	30
Kabëll ushqimi PC	100
Bllok ushqimi (PC) D12-2501A	10
Paste procesori shiringe 20 ml	10
Tastiera pa tela (wireless)	10
Mouse pa tela (wireless)	20
USB C Hub(VGA, HDMI, USB)	10
NAS HDD 3.5", min. 8 TB, min. 5400 RPM	6

Kufje me mikrofon 30

Me mikrofon të inkorporuar dhe lidhje me fishe jack me gjatësi kordoni >1.5 metër

Kompatibël me Sistemet Operative Windows dhe Mac

Teknologji të zërit 3D Audio

Dizenjo e palosshme dhe kontroll te volumit

Monitor 10

Tipi "Type": LCD OSE LED

Madhësia "Size": $\geq 23"$

Rezolucioni "Native Resolution": 1920 x 1080 @ 60 Hz

Raporti i Kontrastit "Constrast Ratio Static": 1000:1

Koha e Rifreskimit "Response Time": ≤ 6 ms

"Display Port": (1) VGA ose DVI dhe (1) prej Portave DP/DVI/HDMI

Kursimi i energjisë "Energy Efficiency": Energy Star

Ushqimi "Power Supply": 220 V AC , 50 Hz

Monitor 10

Tipi "Type": LCD OSE LED

Madhësia "Size": $\geq 21"$

Rezolucioni "Native Resolution": 1920 x 1080 at 60 Hz

Raporti i Kontratit "Constrast Ratio Static": 1000:1

"Display Port": (1) VGA dhe të paktën (1) prej portave DP/DVI/HDMI

Koha e Rifreskimit “Response Time”:	≤ 6 ms
Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:	Energy Star
Ushqimi “Power Supply”:	220 V AC, 50 Hz

1.11 Rinovim Licensa Software teamviewer për kontroll të PC në distancë

OSHEE Group sh.a. ka në përdorim 2 licensa Teamviewer korporatë (corporate) me 3 kanale të njëkohshëm (3 channels) për menaxhimin në distancë të PC. Aplikacioni Teamviewer është instaluar në mbi 1000 pajisje fundore të tipit PC & Laptop.

OSHEE sh.a. kërkon rinovimin e licencave ekzistuese për një periudhë kohore 1 vjeçare.

1.12 Rinovim i licensave ThinkCell.

OSHEE Group sh.a. ka në përdorim software Think-Cell, i cili është një program që integrohet në PowerPoint dhe Excel dhe është projektuar posaçërisht për të bërë krijimin e slideve të biznesit në një kohë më të shpejtë. Sjell mbi 40 lloje të grafikëve, përmirësime vizuale të shtuara nga të dhënat dhe veçori të tjera unike.

OSHEE Group sh.a. kërkon rinovimin e licencave ekzistuese për një periudhë kohore 1 vjeçare.

1.13 Sistem për autentifikim të dyfishtë.

OSHEE Group sh.a. kërkon të implementojë një sistem për autentifikim të dyfishtë, i cili duhet të jetë i integrueshëm me zgjidhje remote access VPN.

1. Karakteristika të përgjithshme.

- Zgjidhja duhet të ofrohet si një platforme software e teknologjisë së fundit, e cila të ofrojë siguri nga kërcënime të ndryshme.
- Zgjidhja duhet të jetë lehtësisht e instalueshme dhe e integrueshme me zgjidhje ekzistuese remote access nga vendorë të ndryshëm si Cisco, Fortinet, Checkpoint etj.
- Zgjidhja duhet të kryejë verifikim të identitetit të menjëhershëm.
- Zgjidhja duhet të ofrojë mbrojtje për çdo aplikacion në pajisjen që është instaluar.
- Zgjidhja të ofrojë verifikim të identitetit, nëpërmjet gjenerimit të një kodi në një pajisje mobile.
- Zgjidhja të ofrojë një aplikacion të dedikuar mobile, i cili të ketë mundësi autentifikimi të shumefishtë.
- Zgjidhja të jetë e integrueshme me Active Directory.
- Zgjidhja të suportojë protokolle autentifikimi si LDAP, SAML.

2. *Siguria e aplikacioneve.*

- Zgjidhja të mos jetë e limituar në integrimin e aplikacioneve.
- Zgjidhja të ketë mundësi t'i ofrojë akses të sigurtë çdo përdoruesi të kompanisë në aplikacionet e brendshme web nga çdo pajisje dhe nga çdo vendndodhje, pa patur nevojë të instalojnë software shtesë remote access në pajisjet e tyre.

3. *Rregullat e autentikimit.*

- Zgjidhja duhet të ofrojë dhe të vendosë rregulla të sigurisë për çdo aplikacion apo në nivel të përgjithshëm.
- Zgjidhja duhet të zbatojë rregulla në bazë të autorizimit në rrjet.
- Zgjidhja të zbatojë rregulla në bazë të vendndodhjes së përdoruesit.
- Zgjidhja duhet të bëjë bllokimin e përdoruesve, në rastin kur aksesimi kërkohet nga rrjete të panjohura apo të dyshuara.
- Zgjidhja duhet të monitorojë, analizojë dhe dedektojë anomalitë apo vulnerabilitet gjatë autentikimit.
- Zgjidhja duhet të vendosë politika besimi kundrejt pajisjeve kompjuterike apo software vulnerabël të tyre si: firewall, enkriptim apo software i vjetëruar.
- Zgjidhja duhet të vendosë politika besimi kundrejt pajisjeve mobile apo software vulnerabël të tyre si: screen lock, biometric, enkriptim apo software i vjetëruar.
- Zgjidhja duhet të njoftojë përdoruesit për të riparuar pajisjet fizike të tyre, në rastet e mospërputhjes me rregullat e sigurisë.
- Zgjidhja duhet të ofrojë kufizim të aksesave të pajisjeve fizike kompjuter apo mobile mbi aplikacionet e brendshme të kompanisë.

4. *Portal i menaxhimit.*

- Të ketë një portal të unifikuar për të administruar përdoruesit, pajisjet dhe vendosjen e politikave që duhet të zbatohen.
- Të monitorojë dhe të identifikojë vulnerabilitetet që mund të vijnë nga pajisjet kompjuterike apo mobile të përdoruesve.
- Të ofrojë shikueshmëri të statusit të pajisjeve dhe përdoruesve.
- Të identifikojë, nëse ka agjentë aktivë të software të tjerë si antivirus apo antimalware.

5. *Kërkesat e software dhe hardware.*

Të suportojë sisteme operative të Microsoft në përdorim nga OSHEE Group sh.a.: Windows server 2012, 2016, 2019.

6. *Licencimi.*

- Zgjidhja të ketë mundësi të licencohet për user.
- Licensimi të jetë i përfshirë në zgjidhje për 100 user-a dhe të jetë i rinovueshëm.

7. *Garancia.*

- Garancia duhet të ofrohet për një periudhë një vjeçare nga vetë prodhuesi dhe të përfshijë qasje në qendrën e tyre të shërbimit, email, chat apo telefon.
- Garancia e ofruar duhet të përfshijë përmirësimin e software të sugjeruar nga prodhuesi.

1.14 Sistem i unifikuar për menaxhim e Microsoft Active Directory

OSHEE Group sh.a. kërkon të implementojë një sistem të unifikuar për shërbime si Domain Controller dhe Help Desk, i cili do të mundësojë lehtësi në menaxhim dhe raportim duke u integruar me shërbime të infrastruktures së saj.

1. Karakteristikat e sistemit.

Zgjidhja të ofrohet si platformë gjithëpërfshirëse për menaxhimin dhe raportimin e shërbimeve si: Exchange, Active Directory, Office 365, Google Apps.

Portali të jetë i aksesueshëm nëpërmjet ndërfaqes web, e cila të menaxhojë: objekte të AD, Mailbox të Exchange, licenca të Office 365.

Zgjidhja të përfshijë funksione si: njësi organizative shërbimi, workflow, automatizim, funksione shtesë për menaxhim të AD.

Zgjidhja të ketë mundësi të integrohet me platforma SIEM, HR Management, Help Desk Software. Zgjidhja të ofrojë funksionalitet të plotë për instalim në pajisje mobile, nëpërmjet një aplikacioni të dedikuar.

Zgjidhja të ketë mundësi të automatizojë detyra të përditshme si: ekzekutim në mënyrë automatike i detyrave të Active Directory, kontroll i detyrave të ekzekutuara, pastrimi i Active Directory.

Zgjidhja të jetë në përputhje me kërkesat sipas standarteve të njohura si HIPAA, SOX apo të tjerë.

Zgjidhja të ketë mundësi të zgjerohet, nëpërmjet licencave shtesë në të ardhmen.

2. Menaxhim.

Të ketë mundësi të krijojë me një hap të vetëm përdorues në AD, Exchange, Office 365, Google Apps.

Të ketë mundësi të modifikojë duke i importuar me file .csv objekte të AD si: përdorues, grup, kontakte, njësi organizimi, kompjutera.

Të bëjë rivendosje të passwordit, zhbllokim apo të fshijë llogari të përdoruesve të AD.

Të bëjë rregullime të përdoruesve, njësive organizative të AD, nëpërmjet dokumenteve të personalizuar.

Të bëjë vendosjen ose revokimin e plotë apo të pjeshme të group policy dhe t'i shpërndajë ato në domain-e, site apo njësi organizimi.

Të bëjë vendosjen, zëvendësimin apo revokimin e licencave të Office 365.

Të bëjë menaxhimin e mailbox-eve të biznesit, mailbox-eve të përbashkëta, në largësi.

3. Raportim.

Të dallojë përdoruesit inaktivë, përdorues të kyçur, kompjuter të kyçur.

Të gjenerojë më shumë se 200 raporte të prekonfiguruar për AD, Exchange, Office365, Google Apps.

Të gjenerojë raporte të personalizuar vetëm për të dhënat e AD që mund të nevojiten.

Të gjenerojë raporte për përdorues apo kompjuter të perzgjedhur në një file .csv.

Të gjenerojë raporte në formate .xls, .xlsx, .csv, .pdf, .html.

Te kete mundesi qe raportet te dergohen ne adresa elektronike individuale ose grup.

4. Help Desk.

Të shpërndajë në mënyrë të detajuar detyra për shërbimet AD, Office 365, G-Suite tek teknikët e help desk.

Të shpërndajë detyra të tilla si: ndryshim passwordi, krijimin e llogarive të përdoruesve etj.

Të shpërndajë detyra pa ndryshuar privilegjet e teknikëve tek Active Directory.

5. Kërkesat e software dhe hardware.

Të suportojë sisteme operativ të Microsoft në versionet: Windows 7, 8, 10, Windows Server 2012, 2016, 2019.

Të suportojë plotësisht browser: Internet explorer, Firefox, Google Chrome, Microsfot Edge.

6. Licencimi.

Zgjidhja të ketë mundësi të licenohet për domain controller.

Zgjidhja të ketë mundësi të licenohet për 10 teknikë Help Desk.

Licencimi të jetë i përfshirë në zgjidhje për dy domain controller, 10 teknikë Help Desk dhe të jetë i përhershëm.

7. Garancia.

Garancia të ofrohet për një periudhë nje vjeçare nga vetë prodhuesi dhe të përfshijë qasje në qendrën e tyre të shërbimit.

Garancia e ofruar të përfshijë përmirësimin e software të sugjeruar nga prodhuesi.

1.15 Sistem për auditim në kohë reale të Microsoft Active Directory

OSHEE Group sh.a. kërkon të implementojë një sistem auditimi të unifikuar për monitorim në kohë reale për shërbime si Domain Controller, File Server, Windows Server, duke u integruar me shërbime të infrastrukturës së saj.

1. Karakteristika të përgjithshme.

Zgjidhja duhet të ofrojë monitorim të dedikuar për aktivitetin e përdoruesve.

Zgjidhja duhet të bëjë analizimin e bllokimit të llogarive dhe sjelljes së përdoruesve.

Zgjidhja duhet të ketë ndërveprim automatik ndaj sulmeve kërcënuese.

Zgjidhja të bëjë raporte të përgatitura të pajtueshme me standartet e njohura.

Zgjidhja të jetë plotësisht e integrueshme dhe e të njëjtit prodhues me sistemin e unifikuar për menaxhim dhe raportim.

Zgjidhja të exportojë raporte në formate .xls, .csv, .pdf, .html.

Zgjidhja të jetë në përputhje me kërkesat, sipas standarteve të njohura si HIPAA,SOX apo të tjerë.

Zgjidhja të ketë mundësi të zgjerohet nëpërmejt licencave shtesë në të ardhmen.

2. Karakteristikat e sistemit për Domain Controller.

Të ofrojë monitorim në kohë reale, analizim të sjelljes së përdoruesve, grupeve në Active Directory.

Të ofrojë kontroll nëpërmjet raporteve të Active Directory duke mbajtur infrastrukturën IT të sigurt dhe të pajtueshme me standartet e njohura.

Të kontrollojë të gjitha ndryshimet që mund të ndodhin tek: përdoruesit, grupet, kompjuterat, group policy apo njësi organizimi të AD.

Të monitorojë aktivitetin e kyçjes/ç'kyçjes së përdoruesve, përpjekjet e sukseshme apo të dështuara nëpërmjet rrjetit.

Të ofrojë funksione të avancuara statistikore në zbulim të anomalive apo sjelleve dashakeqëse.

Të ketë mundësi të përdorë mbi 200 raporte të mbledhur me ngjarje specifike dhe me përmbajtje të hollësishme.

3. Karakteristikat e sistemit për File Server.

Të monitorojë aktivitetin e kyçjes/ç'kyçjes së përdoruesve, përpjekjet e sukseshme apo të dështuara në këto file sever.

Të mundësojë kontroll të ndryshimit të skedarëve apo folder-ave ne file server.

Të monitorojë në kohë reale ndryshimet që mund të bëhen në integritetin e konfigurimeve apo roleve të file-ve, folderave.

Të mundësojë kontrollin dhe përmbledhjen e ngjarjeve rreth ndryshimeve në file server.

Të monitorojë integritetin e direktorive, të cilat janë bërë share në rrjet.

Të mundësojë evidenca për ndryshimet e autorizimeve dhe sigurisë.

4. Karakteristikat e sistemit për Windows Server.

Të monitorojë aktivitetin e kyçjes/ç'kyçjes së përdoruesve, përpjekjet e sukseshme apo të dështuara në këto Windows Server

Të mundësojë monitorim të integritetit të skedarëve.

Të mundësojë autentikimet RADIUS.

Të kontrollojë aktivitetin e pajisjeve USB gjatë përdorimit në Windows Server.

Të kontrollojë aktivitetin e shërbimeve të printimit në Windows Server.

Të monitorojë, njoftojë, raportojë rreth shërbimeve të implementuara si: AD FS, AD LDS, LAPS, DNS.

5. Kërkesat e software dhe hardware.

Të suportoje sisteme operativë të Microsoft në versionet: windows 7, 8, 10, Windows Server 2012, 2016, 2019.

Të suportoje plotësisht browser: Internet explorer, Firefox, Google Chrome, Microsoft Edge.

Të suportoje databaza si: MySQL, MS SQL, PostgreSQL

6. Licencimi.

Zgjidhja të ketë mundësi të licenohet për Domain Controller.

Zgjidhja të ketë mundësi të licenohet për File Server.

Zgjidhja të ketë mundësi të licenohet për Windows Server

Licencimi të jetë i përfshirë në zgjidhje për dy domain controller, dy file server dhe 5 Windows Server dhe të jetë i përhershëm.

7. Garancia.

Garancia të ofrohet për një periudhë një vjeçare nga vetë prodhuesi dhe të përfshijë qasje në qendrën e tyre të shërbimit.

Garancia e ofruar të përfshijë përmirësimin e software të sugjeruar nga prodhuesi.

2. Garanci për suport për infrastrukturën e serverave.

Objekti i garancisë për suport

OSHEE Group sh.a. me anë të këtij prokurimi, ka për qëllim të sigurojë funksionalitetin e këtyre pajisjeve dhe riparimin e tyre sipas specifikimeve të përcaktuara në këtë dokument, në mënyrë që problematikat dhe defektet hardware të mos afektojnë punën.

Garancia për suport të sistemeve të Serverave

Kompania duhet të ofrojë garanci për suport për serverat aktualisht në gjendje pune dhe sipas tabelës së dhënë në vijim.

Termet e Garancisë për Suport:

- Kompania duhet të ketë skuadër të dedikuar për suportin, mundësi të qendërimit të thirrjeve dhe një kontakt të vetëm që koordinon dhe menaxhon thirrjet e OSHEE Group sh.a.
- Kompania duhet të sigurojë kohë të shpejtë të pranimit të thirrjes, maksimumi 1 orë nga log-ini i thirrjes së OSHEE Group sh.a.
- Tekniku duhet të paraqitet në vendndodhjen e OSHEE Group sh.a. brenda 4 (katër) orëve nga log-ini i thirrjes dhe raportimit të problemit, në rast se thirrja konsiderohet urgjente, si dhe brenda ditës së nesërme të punës për thirrje jo urgjente. Tekniku gjatë kohës së paracaktuar duhet të fillojë diagnostikimet on-site dhe mbështetje për zgjidhjen e problemeve.
- Kompania duhet të sigurojë gatishmërinë e suportit në orarin: 8:30-17:00.
- Kompania duhet të sigurojë garanci për suport të plotë të hardware-it me zëvendësim falas të pajisjes ose pjesëve të këmbimit në rast defekti.
- Në rast ndërrimi të pajisjeve, kompania ofruese e garancisë për suport duhet të ndërrojë pajisjet e dëmtuara dhe të kryejë konfigurimet bazë të nevojshme pas ndërrimit.
- Kompania duhet të sigurojë diagnostikime proaktive me mbështetje të vendor-it dhe hapje case TAC, Update të software-ve të Sistemit të Operimit (OS), duke përfshirë minor, major releases.
- Kompania duhet të kryejë update të Software-ve.

Nivelet e garancisë për suport dhe proceset

Kompania duhet të ofrojë shërbime të Garancisë për suport dhe mirëmbajtjes, sipas niveleve të shërbimit dhe metodikës së përshkruar më poshtë:

1. Suport proaktiv.

Kompania duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në javë, shërbime dhe suport proaktiv, të cilët do të mundësojnë dedektimin në kohë të problematikave dhe do të

mundësojnë ndërmarrjen në kohë të hapave rekuperuese, për të mos patur ndërprerje të shërbimit. Të gjitha shërbimet e suportit proaktiv do të kryhen pranë ambienteve të OSHEE Group sh.a., përveç rasteve kur OSHEE Group sh.a. përcakton një vendndodhje të re për kryerjen e këtyre shërbimeve.

2. Shërbime Riparimi ne vendndodhje (mjediset e OSHEE Group sh.a.).

Kompania duhet të jetë e disponueshme gjatë interval kohor, nga e Hëna në të Premte, 8:00 me 17:00, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të "Alarmeve Madhore" të raportuara nga personeli i autorizuar i OSHEE Group sh.a. ("Emergency On-Call Hours").

Me termin *Alarm Madhor*, do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për shërbime riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të Sistemeve të mbuluara që i pengon ato të operojnë në përputhje me Specifikimet dhe shkaktjnë ndërprerje të menjëhershme e të konsiderueshme të Sistemit dhe që nuk mund të shmangeshin me anë të ndërhyrjeve dhe riparimeve minore të kryera nga stafi teknik i OSHEE Group sh.a. dhe të rekomanduara nga Kompania. Problemet që nuk i përkasin "*Alarmeve Madhore*", duhet të adresohen nën Shërbime te Suporti proaktiv.

3. Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore.

OSHEE sh.a.do të njoftojë Kompaninë me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet një nderfaqeje web të vënë në dispozicion dhe do të presë të kontaktohet nga Kompania me telefon, gjatë "Emergency On-Call Hours". Kompania duhet të kontaktojë OSHEE sh.a. dhe të konfirmojë marrjen e Alarmit Madhor, brenda 30 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar i OSHEE Group sh.a. Në momentin e njohjes së thirrjes nga Kompania, OSHEE Group sh.a. do të vendosë në dispozicion informacione të paracaktuara në *Procedurat e Troubleshooting* nga Kompania dhe do ta asistojë atë gjatë diagnostikimit të problemit të raportuar. OSHEE Group sh.a. do të bashkëpunojë me kërkesën e Kompanisë për ta ndihmuar atë, në përcaktimin e shkaktit të problemit të raportuar dhe në përcaktimin e nevojës për vizitë në vendndodhje për të kryer Shërbimet e Riparimit.

4. Përgjigja ndaj Alarmeve Madhore.

Nëse Kompania nuk mund të përcaktojë nëpërmjet informacionit të mbledhur nga *Procedurat e Troubleshooting* shkaktun e Alarmit madhor, atëherë ajo duhet të dërgojë një Teknik Shërbimi pranë OSHEE Group sh.a. brenda intervalit kohor prej dy (2) orësh nga momenti i marrjes së njoftimit për Alarm Madhor. Me të arritur, tekniku i kompanisë do të mbështetet me asistencë

nga OSHEE Group sh.a. dhe do t'i jepet liri veprimi në mjediset dhe sistemet e mbuluara, për të filluar menjëherë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit.

5. Veprimtarite e Diagnostikimit dhe Riparimit.

Me të mbërritur në vendndodhje, tekniku i shërbimit duhet të fillojë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit. Kjo veprimtari duhet të vazhdojë deri sa:

- (a) Alarmi madhor të jetë korrigjuar ose të jetë "zgjidhur në mënyrë të tërthortë",
- (b) Tekniku të jetë zëvendësuar me një person tjetër.
- (c) Kompania të përcaktojë, se problemi i raportuar nuk është shkaktuar nga ndonjë keqfunksionim i Sistemeve të mbuluara ose
- (d) Kompania arrin në konkluzionin që diagnostikimi ose korrektimi i mëtejshëm mund të shtyhet deri në mbërritjen e pjesëve të këmbimit.

Teknikët e shërbimit të kompanisë duhet të jenë të trajnuar, certifikuar dhe autorizuar për të ndërvepruar në mënyrë direkte me prodhuesin.

Në rast se do jetë i nevojshëm zëvendësimi i pjesëve të këmbimit, atëherë kompania duhet të kryejë të gjitha procedurat respektive me prodhuesin për lokalizimin e pjesës, heqjen, eksportin, transportin, importin, vendosjen dhe rikonfigurimet përkatëse. Kostot e pjesëve të dëmtuara dhe kostot e shërbimit do të merren përsipër nga kompania për të gjithë periudhën e kontratës.

Garanci për shërbime të tjera

Kompania duhet të krijojë/diskutojë me OSHEE Group sh.a. një axhendë periodike kontrollesh si më poshtë:

1. Javore
 - (i) Kontrolle të log-eve të serverave;
 - (ii) Mirëmbajtje proaktive;
2. Mujore
 - (i) Testim / kontroll i kompletuar i pjesëve më kritike të infrastrukturës HW të OSHEE sh.a.;
 - (ii) Kontroll i detajuar i gjithë log-eve hardware dhe analizë e tyre;
 - (iii) Rekomandime për upgrade të mundshme hardware.

2.1 Garanci për Suport HP Servers

OSHEE Group sh.a. kërkon të mbulojë me garanci për suport pajisjet ekzistuese nga Prodhuesi HPE. Koha e mbulimit me garanci për suport: 1 vit. Specifikimet si më poshtë:

Përshkrim	Numri Serial	Sasia	Kohëzgjatja
HP DL560 Gen8 CTO Server	SN: CZ252600WP	1	1 vit
HP DL560 Gen8 CTO Server	SN: CZ252600WN	1	
HP DL560 Gen8 CTO Server	SN: CZ252600WK	1	

HP DL560 Gen8 CTO Server	SN: CZ252600WM	1	
HP DL560 Gen8 CTO Server	SN: CZ252600WL	1	

2.2 Garanci për Suport DELL Server

OSHEE Group sh.a. kërkon të mbulojë me garanci për suport pajisjet ekzistuese nga Prodhuksi DELL EMC. Koha e mbulimit me garanci për suport: **1 vit**.

Përshkrim	Numri Serial	Sasia	Kohëzgjatja
PowerEdge R820	SN: H5T9F02	1	1 vit

2.3 Garanci për Suport CISCO Server

OSHEE Group sh.a. kërkon të mbulojë me garanci për suport server ekzistues nga Prodhuksi CISCO. Koha e mbulimit me garanci për suport: **1 vit**.

Përshkrim	Numri Serial	Sasia	Kohëzgjatja
USC-SP6-C220V UCS SP C220 SFF VALUE w/2x E5-2643,32 GB, 1225 VIC, 9266CV	FCH1709V0W9	1	1 vit

2.4 Garanci për Suport Fujitsu Servers

OSHEE Group sh.a. kërkon të mbulojë me garanci për suport pajisjet ekzistuese nga Prodhuksi Fujitsu.

Koha e mbulimit me garanci për suport: **1 vit**.

Përshkrim	Numri Serial	Sasia	Kohëzgjatja
Server Fujitsu Primergy RX4770 M3	SN: YM9A001275	1	1 vit
Server Fujitsu Primergy RX4770 M3	SN: YM9A001276	1	
Server Fujitsu Primergy RX4770 M3	SN: YM9A001277	1	
Server Fujitsu Primergy RX4770 M3	SN: YM9A001278	1	
Server Fujitsu Primergy RX4770 M3	SN: YM9A001279	1	
Server Fujitsu Primergy RX2530 M2	SN: YM6B00572	1	
Server Fujitsu Primergy RX2530 M2	SN: YM6B005726	1	

3. Garanci për Suport për Data Storages.

Objekti i garancisë për suport

OSHEE Group sh.a., me anën e këtij prokurimi, ka për qëllim të sigurojë funksionalitetin e këtyre pajisjeve dhe riparimin e tyre sipas specifikimeve të përcaktuara në këtë dokument, në mënyrë që problematikat dhe defektet hardware të mos afektojnë punën.

Përshkrimi i Garancisë për suport sipas specifikimeve teknike më poshtë:

Suport Teknik	Nëpërmjet telefonit ose faqes web 24x7 me EMC Të ofrohet nga EMC: 1. Përgjigje teknike nëpërmjet remote sipas nivelit të sigurisë së problemit. 2. Onsite response (përgjigje në vend). Koha e përgjigjes e kërkuar: Niveli i sigurisë 1: 1 orë, 24x7. Niveli i sigurisë 2: 3 orë; 24x7. Niveli i sigurisë 3: 4 orë lokale biznesi. Niveli i sigurisë 4: 10 orë lokale biznesi.
Përgjigje onsite (në vendndodhje)	Dërgimi i personelit të autorizuar në site për të punuar mbi problemin, pasi kjo shikohet si e nevojshme nga EMC. Të përfshihet vetëm për pajisjen Intervenimi on-site max. 6 orë kohë riparimi Përgjigja onsite (në vendndodhje) të mos aplikohet për software, por të ketë mundësi të blihet veç.
Lëvrimi i pjesëve zëvendësuese	Po (6 orë kohë riparimi).
Të drejtë për Versionet e reja të software	Po
Monitorim dhe riparim nëpërmjet remote 24x7	Po
Akses 24x7 online support	Po

